



PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Shërbim

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: “STUDIM PROJEKTIM I RRUGËS FSHATIT KËRCUKAJ RRUGË DHE KUZ L=3.1KM , BASHKIA RROGOZHINË”

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 79415200-8, 71322000-1

Vlera e fondit limit: 10,000,000 (Dhjetë milion) lekë pa tvsh.

lekë pa tvsh.

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 4 (katër) muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor, **Bashkia Rrogozhinë**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas shtojcës 10.**

b. Sigurimin e Ofertës, **sipas Shtojcës 3**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe në VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas Shtojcës 9 të DST

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6,



të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar;

2.2.1. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **40%** e vlerës së parashikuar të kontratës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr.10091 date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar", i ndryshuar.

2.2.2 Kopje të çertifikuara të balanceve të tre viteve të fundit (2022, 2023, 2024) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Shëmin: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitetin financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024 si dhe kështu për vitin 2025 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës sipas adresave të regjistruar sipas QKB. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar); Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (e ndryshuar) si dhe sipas Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" (i ndryshuar).



Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, **Bashkia Rrogozhinë**, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

2.3 Për kapacitetin teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se **20 %** të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që:

Shërbime të ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se **20 %** të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Gjithashtu referuar VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Kreu XI, Neni 88, pika 3, citohet se: “Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.” AK argumenton se shërbimet e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e shërbimeve të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar ku qartazi përcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, **autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë** burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe **përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë**



të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, **Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.***

AK argumenton se shërbimet e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas kërkesave, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e shërbimet publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Në kuader të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa më të drejtë, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontrates së bashkepunimit; me marrëveshjen e nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nenkontraktimit lëshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjellë kufizim të pjesëmarrjes së OE në tender as në mënyrë direkte dhe as në mënyrë indirekte.

Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore që parashikon legjislacioni i prokurimit publik.

Gjithashtu vendos në kushte të barabarta dhe u jep mundësi të gjithë OE Ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit mund të jenë të paplotesuara sipas standartit.

AK ka kërkuar këto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku ndër të tjera përcaktohet se: **Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.**

2.3.2 Licensa profesionale lidhur me shërbimet objekt i kontratës:

Licensa profesionale të operatorit ekonomik (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga MZHUT ose nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim, ku të përfshihen kategoritë:

PROJEKTUES ARKITEKT

d- Projektim peisazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërta, lulishte e parqe.



3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

- c) 1. Objekte me shkallë të lartë vështirësie Beton arme – metalike
- d) Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike.

4. PROJEKTUES INSTALATOR

- c) Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale;
- d) Projektim të sistemeve komplekse të telekomunikacionit;
- f) Projektim të sistemeve kundra zjarrit;
- i) Projektimi i ndricimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndricimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroporteve, etj.;
- j) Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit, etj, për objektet civile dhe industrial.

5. PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE

- b) Projektim furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi;
- c) Projektim ujësjellës kanalizime-Urbane -Rurale.

6. PROJEKTUES RRUGE – HEKURUDHA

- a) Projektimi rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane kryesore;
- b) Projektimi rrugë urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore.

7. PROJEKTIM DHE VEPRA ARTI

- a) Projektimi ura dhe vepra artite vogla deri 10m;
- b) Projektimi ura dhe vepra artite vogla mbi 10m;
- c) Projektim ura/Viadukte me hapësira të mëdha dritë, ura të varura, ura me sisteme pacaktuara statikisht dhe sisteme tjera speciale.

8. PROJEKTUES GJEODET

- a) Rilevime inxhinierike;
- b) Rilevime inxhinierike kadastrale;
- c) Sistemet GIS.

9. STUDIM GJEOLIGO INXHINIERIK - HIDROGJEOLOGJIK

- a) Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile – ekonomike deri 5 kate;
- d) Studim /vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët.

10. PROJEKTIMI I IMPIANTËVE TË PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

- c) Impiante të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike – diellore – era etj;
- e) Projektim kabina elektrike të rrjetit shpërndarës – linja të tensionit të ulët – të mesëm.

11. PROJEKTUES TE SINJALIZIMIT RRUGOR



a) Projektim sinjalistike jo ndricuese, në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe dhe parkime.

(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë **Licensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim lëshuar nga MZHUT** ose institucione të tjera të autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e liçensave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 41, pika 4, gërma a) të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe Vendimin Nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në Nr. 943, datë 28.12.2016.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Kategoritë e studim projektimit janë vendosur në përputhje me detyrat dhe objektivat e përshkruara te Termat e Referencës.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të ketë si drejtues teknik stafin si më poshtë dhe të jenë të përfshirë në listëpagesën e shoqërisë për muajin e fundit të deklaruar:

- 1 Inxhinier Ndërtimi
- 1 Inxhinier Hidroteknik
- 1 Inxhinier Elektrik
- 1 Inxhinier Mekanik
- 1 Inxhinier Gjeolog
- 1 Arkitekt
- 1 Inxhinier Topograf/Gjeodet /Markshajder

Për stafin e përcaktuar më sipër pika 2.3.3, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

Kontratat individuale të punës (të vlefshme), Licencat profesionale, Diplomë si dhe të figurojnë në listëpagesa për muajin fundit të deklaruar, të vërtetuar me:



- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhën e fundit të deklaruar;
- b) Listëpagesa e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e fundit të deklaruar para hapjes tenderit.
- c) Punonjësit duhet të jenë të regjistruar në listëpagesë për periudhën e fundit të deklaruar para hapjes tenderit.)

Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

Shënim: Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhes të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr.10 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të fushës objekt prokurimi (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë shërbimin e kërkuar rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar si me siper, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Shënim: Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhes të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr.10, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

2.3.4 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë ekspertë si më poshtë:

- 1 (një) punonjës Ekspert Zjarrëfikës
- 1 (një) punonjës Ekspert mjedisi (i pajisur me certifikatën e VNM)
- 1 nje punonjës Ekspert Gis
- 1 Ekspert preventivues Inxh Ndertimi ose Inxh Hidroteknik

Ekspertet e mesiperm duhet figurojnë në listëpagesat e operatorit ekonomik në periudhën e deklaruar para hapjes tenderit.

(Këto tre ekspert mund të jenë dhe njëkohësisht dhe pjesë e eksperteve të stafit drejtuesve teknik dhe stafit mbështetës të lartëpërmendur në pikat 2.3.4 dhe 2.3.5)



Shënim: Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 10. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për Ekspert Zjarrefikes, është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 49, pika 4 të Ligjit Nr.152/2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin“, ku citohet se: “Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së jep certifikatë për personat fizikë e juridikë për ushtrimin e aktivitetit të ekspertit zjarrefikës privat, në bazë të kriterëve të veçanta të miratuara me udhëzim të ministrit”.

Theksojmë se, për shkak të natyrës së shërbimit objekt prokurimi shihet e nevojshme dhe e domosdoshme prania e 1 (nje) specialist Ekspert Zjarrefikes.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njesia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar dhe ekspertiza mjedisore bazuar në ligjin Nr. 10440, datë 7.7. 2011 dhe vendimet në vazhdim është i domosdoshëm dhe duke u bazuar në termat e references dhe shkallës së vështirësisë për objektet që parashikohen të jenë pjesë e kësaj marreveshjeje dhe efektshmerine në projektimin me sukses të tyre. Kërkesa për ekspertin GIS dhe inxhinier ndertimi ose hidroteknik mbështetet në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.5 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij mbi 12 (Dymbëdhjetë) punonjës.

Shënim: Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr.10 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë: për përcaktimin e fuqisë punëtore



minimale të kerkuar argumentojme se jemi bazuar ne sherbimet e kerkuara sipas Termave te References dhe stafin e permendur ne pikat e mesiperme Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë, tregon besueshmëri për autoritetin. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku të citohet lista e të gjithë stafit i cili do të jetë i angazhuar në këtë kontratë.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Lista e stafit: per percaktimin e fuqise punëtore minimale te kerkuar argumentojme se jemi bazuar ne sherbimet e kerkuara sipas Termave te References dhe stafin e permendur ne pikat e mesiperme Lista e stafit te cilet do te kryejne sherbimet e kerkuar, i jepautoritetit kontraktor besueshmëri dhe siguri duke i vene ne dispozicion personat te cilen do te kryejne sherbimin sipas kerkesave te ketij objekt kontrate.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Certifikatat të përshtatshme **ose ekuivalentet e tyre** për objektin e prokurimit si më poshtë:

- a) ISO 9001: 2015, Për menaxhimin e cilësisë (menaxhim i kualifikuar i sistemit të operimit dhe cilësisë);
- b) ISO 14001: 2015, Për menaxhimin e cilësisë së mjedisit;
- c) ISO 45001-2018 (e vlefshme). Sistemi i Menaxhimit për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë.

Shënim: Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizojë sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

Argumentimi: Kerkesat e mesiperme jane vendosur bazuar ne Nenin 79, pika 1 te Ligjit Nr. 162/2020, “Per prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”

Certifikatat e cilesise jane bazuar ne perputhje dhe jane ne perputhje me natyren dhe



objektin e kontrates qe prokurohet.

- a) ISO 9001: 2015, Për menaxhimin e cilësisë;

Certifikata e Sistemit te Menaxhimit te Cilesise (Quality Management System - QMS): Ky standard ka te beje me menaxhimin e cilesise dhe sigurimin e proceseve te projektit. Certifikimi sipas ISO 9001 konfirmon se studioja ka vendosur standarde te larta per proceset e saj dhe ka nje sistem efektiv te menaxhimit te cilesise.

- b) ISO 14001: 2015, Për menaxhimin e cilësisë së mjedisit;

Certifikata e Sistemit te Menaxhimit te Ambientit (Environmental Management System - EMS): Nje studio projektuese qe merret me dizajnimin e projekteve ndikon ne ambientin, keshtu qe certifikimi sipas ISO 14001 tregon qe studioja angazhohet per te pasuruar mjedisin dhe t'i minimoje ndikimet negative ne ate.

- c) ISO 18001-2007, ekuivalente me ISO 45001-2018 (e vlefshme). Sistemi i Menaxhimit për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë;

Certifikata e Sistemit te Menaxhimit te Sigidurise dhe Shendetit ne Pune (Occupational Health and Safety Management Systems - OHSMS): Ky standard konfirmon se studioja ndjek nje sistem efektiv te menaxhimit te sigurise dhe shendetit te punonjesve te saj, duke garantuar nje mjedis pune te sigurve dhe te shendetshem per ekipin e saj.

Në rast bashkimi operatorësh, kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me fushat e zbatimit të pjesëmarrjes në kete shërbim, të përcaktuara në akt marrëveshje.

2.3.8 Operatori duhet te kete ne pronesi ose me qera 2 automjete ku te pakten njera te jete 4x4.

- **Për mjetet që shënohen në regjistrat publik duhet të paraqiten:**

1. Leje qarkullimi e vlefshme,
2. Certifikatë e kontrollit teknik të vlefshme
3. Policë sigurimi e vlefshme
4. Certifikatë për leje transporti të lëshuar nga Bashkia për vete ose për të tretë.

- **Për mjetet me qira:**

1. Duhet të paraqitet kontrata noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj



2. Certifikatë e kontrollit teknik të vlefshme
 3. Policë sigurimi e vlefshme
 4. Certifikatë për leje transporti të lëshuar nga Bashkia për vete ose për të tretë.
- **Kontrata e bashkëpunimit me kompani transporti:**
 1. Leje qarkullimi e vlefshme,
 2. Certifikatë e kontrollit teknik të vlefshme
 3. Policë sigurimi e vlefshme
 4. Certifikatë për leje transporti të lëshuar nga Bashkia për vete ose për të tretë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 40, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Kriteri vlerësohet si i nevojshëm për ekzekutimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht skualifikimi.

Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s’kualifikimi.

Operatori ekonomik ofertues në përllogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr.5585 Prot., Datë 25.07.2017 të Agjencisë së Prokurimit Publik “Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.



Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet të jetë brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të VKM-së nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, i ndryshuar.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

NJESIA E PROKURIMIT